



Prishtinë: 02.09.2021
Kodi i ZRRE-së: V_1387_2021

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_2196_06_21 të dt.17.06.2021**;
- Ankesën e konsumatorit të dt. 08.06.2021;

në seancën e mbajtur më datë **02.09.2021** nxori këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** ankesa e konsumatorit I.B nga Komuna e Pejës, si e pabazuar.
- II. **MBETET në fuqi**, vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me nr. ZRrE/DMK_V_2196_06_21, i datës 17.06.2021.

A r s y e t i m

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve me datë 17.06.2021 ka marrë vendim me nr. ZRrE/DMK_V_2196_06_21 me të cilin e ka refuzuar ankesën e konsumatorit I.B nga Komuna e Pejës, lidhur me kontestimin e Përgjigjes së KESCO-s, Departamenti për Konsumatorë, lidhur me ndërrimin e grupit tarifor nga komercial (7/02) në grupin tarifor shtëpiak (4/02).

I pakënaqur me Vendimin e DMK-së, konsumatori I.B, brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë në Bordin e ZRrE-së për këto shkaqe:

- Shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës administrative;
- Vërtetimit të gabueshëm ose vërtetimit jo të plotë të gjendjes faktike dhe
- Për shkak të aplikimit të gabueshëm të ligjit material.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 02.09.2021 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuar nga palët në kontest, si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Konsumatori në ankesën e tij pretendon që njehsori elektrik me shifrën DPE-9064194, përdoret për furnizim me rrymë elektrike për konsum familjar, ngase ky njehsor gjendet i vendosur në shtëpinë e cila përdoret për plotësimin e nevojave të banimit të parashtruesit të ankesës dhe se pjesa e ndërtesës e cila e cila përdoret për qëllime afariste furnizohet me rrymë elektrike nga njehsori elektrik në emër të DEPO – N.T.P. “HILTI”. Bordi pas analizimit të shkresave të lëndës, sqaron se, në asnjë pjesë të



vendimit të shkallës së parë të ZRrE-së nuk është mohuar fakti që ekzistojnë dy njehsorë, respektivisht njehsori nr. 20023706, në grupin tarifor komercial 7/02 dhe njehsori elektrik nr. 20019941, i cili është hasur nga punëtorët e KEDS-it dhe ka qenë i kyçur në mënyrë ilegale. I njëjti është shkyçur nga rrjeti elektrik dhe është obliguar konsumatori që të bëj kërkesë për lajmërim. Pra, nga Procesverbali i inspektimit nr. 2296155 i datës 04.04.2019, shihet qartë se konsumatori ka qenë i kyçur në rrjetin elektrik pa autorizimin e ndërmarrjes, e që kjo është në kundërshtim me dispozitat ligjore të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, pasi që, konsumatori fillimisht duhet të aplikoj për lidhje të re, të plotësohen të gjitha kushtet teknike dhe më pas të bëhet kyçja fizike.

Bordi po ashtu thekson se, nuk ka asnjë element që do të kontestonte vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike nga DMK e ZRrE-së, sepse duke u bazuar në transaksionet dhe rrjedhën e energjisë elektrike aktive, vërehet se konsumatori me shifër DPE – 9064194 për herë të parë është regjistruar me datë 06.05.2019 përmes faturës së shërbimeve (lidhje e re) në vlerë prej 188.80 EUR, ndërsa fatura e parë konsumatorit i ka arritur në muajin 05/2016 në vlerë prej 386.37 EUR dhe se është regjistruar si konsumator i grupit tarifor 4 (komercial 7/02).

Bazuar në procesverbalet e inspektimit të KEDS nr.2378789 të datës 28.05.2019 dhe nr.2310855 të datës 02.09.2019, si dhe fotografive të ofruara nga KEDS lidhur me ankesën e konsumatorit, vërehet se në objektin ku është e kyçur shifra DPE – 9064194 është duke u ushtruar veprimtari afariste dhe si të tillë nuk mund të ndërrohet grupi tarifor nga grupi tarifor 4 (konsumator jo familjar) në grupin tarifor 5 (konsumator familjar), përderisa ende ushtrohet kjo veprimtari afariste. Arsyeja e mos ndërrimit të grupit tarifor është se tarifat e energjisë elektrike për konsumatorët familjar dhe jofamiljar janë të ndryshme, dhe se faturimi i energjisë elektrike duhet të bëhet bazuar se cilës kategori konsumatori i takon, e që sipas procesverbaleve të inspektimit dhe fotografive të ofruara nga KEDS shihet se te konsumatori me shifër DPE – 9064194 ushtrohet veprimtari afariste, andaj edhe tarifat duhet të jenë të grupit tarifor 4 (konsumator jofamiljar).

Sa i përket pretendimit për aplikim të gabueshëm të ligjit material, Bordi i ZRrE-së thekson se për mënyrën se si është vendosur në dispozitiv të vendimi, parashihet decidivisht në dispozita ligjore në vijim:

Sipas nenit 51, paragrafi 4 i Ligjit për Energjinë Elektrike dhe neni 10, paragrafi 1 i Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji thuhet se Operatori i Sistemit mund të refuzoj të kyçë një aplikues për kohësisht, vetëm nëse ajo kyçje nuk është në përputhje me dispozitat e Kodit të Rrjetit dhe Shpërndarjes ose kodeve tjera në fuqi.

Bazuar në legjislacionin primar dhe sekondar të fushës së energjisë elektrike ekzistojnë dy kategori të konsumatorëve: konsumator familjarë dhe jo familjarë. Në nenin 3, paragrafi 1 të Ligjit për Energjinë Elektrike (LIGJI Nr. 05/L – 085) janë të përshkuara përkufizimet e konsumatorëve, ku **konsumator familjar** është konsumator i energjisë elektrike që blen energji elektrike për konsum vetanak për ekonominë e vet familjare, duke mos përfshirë veprimtaritë komerciale apo profesionale. Për objektet që shërbejnë për qëllime fetare aplikohen tarifat e konsumatorëve familjar. Ndërsa **konsumator jofamiljar** është person fizik a juridik që blen energji elektrike të cilën nuk e shfrytëzon për nevoja të veta familjare, e ku përfshihen edhe prodhuesit dhe blerësit me shumicë. Këto përkufizime janë të njëjta edhe në Rregullën për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji.



Andaj, duke u bazuar në të gjitha shkresat e lëndës, shihet qartë se shifra e konsumatorit DPE – 9064194 nga fillimi ka qenë e regjistruar si konsumator jo-familjar, pasi që në atë pjesë të objektit është duke u bërë veprimtari afariste dhe kjo vërtetohet edhe nga fotografitë e ofruara nga KEDS gjatë inspektimeve të bëra në teren. Bordi i ZRrE-së bazuar në shkresat e lëndës konstaton se, konsumatori në fjalë duhet që të bëjë ndarjen e objektit, respektivisht ndarjen e instalimit elektrik të objektit, ku për objekt familjar duhet ta ketë instalimin ndaras nga pjesa e objektit ku është duke u ushtruar veprimtari afariste (komerciale). Pra konsumatori në momentin që e bënë ndarjen e instalimit elektrik të pjesës së objektit për banim familjar, ai duhet që konform nenit 8 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, të aplikon në KESCO/KEDS për lidhje të re (kyçje në rrjetin elektrik). Duhet theksuar se Kodi i Shpërndarjes së Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes e rregullon plotësimin e kushteve teknike që duhet të plotësohen me rastin e aplikimit për kyçje nga aplikuesi. Pra, neni 4.4.2 i Kodit të Shpërndarjes së OSSH e përcakton edhe informatat apo dokumentet që duhet të plotësohen nga aplikuesi për kyçje në rrjetin elektrik të shpërndarjes. Ndërsa nëse konsumatori dëshiron që te shifra DPE – 9064194 të ndërroj grupin tarifor nga grupi tarifor 4 (konsumator jo-familjar) në grupin tarifor 5 familjar, atëherë konsumatorit duhet që te shifra DPE- 9064194 të mos ushtroj asnjë aktivitet afarist, dhe të dëshmoj përmes ndonjë dokumenti zyrtar që nuk është duke ushtruar ndonjë aktivitet afarist, dhe të parashtron kërkesë për ndërrim grupi tarifor, pasi që tarifat e energjisë elektrike nuk janë të njëjta për konsumatorët familjar dhe jo familjar.

Dhe duke u bazuar në faktet si në vijim:

- Që konsumatori që nga fillimi ka qenë i regjistruar si konsumator i grupit tarifor 4 (komercial 7/02);
- Se në objektin ku është e kyçur shifra e konsumatorit, është duke u ushtruar veprimtari afariste;
- DMK e ka udhëzuar konsumatorin që të kërkoj zgjidhje teknike nga KEDS/KESCO, për ndarjen e objektit, respektivisht ndarjen e instalimit elektrik;
- Dhe se sipas rregullave dhe procedurave në fuqi, nuk mund të bëhet ndërrimi i grupit tarifor në të njëjtin objekt në të cilin ushtrohet veprimtari afariste, Bordi vendosi për refuzimin e kësaj ankese.

Bordi i ZRrE-së pas analizave të bëra, dëshmimeve dhe argumenteve të paraqitura nga palët e ne veçanti rrjedhën e energjisë elektrik, procesverbalet e inspektimit të KEDS nr.2378789 të datës 28.05.2019 dhe nr.2310855 të datës 02.09.2019, procesverbalet e inspektimit nr.0006549 të datës 23.04.2019 dhe procesverbalet e ndërrimit të njehsorit elektrik nr.0873383 të datës 23.04.2019, procesverbalet e inspektimit nr.2296155 të datës 04.04.2019, formulari për konfirmim administrativ për pëlqim parimor, pëlqim elektroenergjetik/lidhje te re, Ligji për Energjinë Elektrike, Kodi i Shpërndarjes së OSSH, Rregulla për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

Bordi i ZRRE, gjithashtu ka konstatuar se konsumatori në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar pa ofruar prova të arsyeshme.



Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 02.09.2021 pas analizimit të gjithë asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.

IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Ymer Fejzullahu, Kryesues

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

Lutfije Dervishi, anëtare

Gani Buçaj, anëtar

Vendimi u dërgohet:

- KESCO-së
- Konsumatorit I.B dhe
- Arkivit të ZRRE-së.